

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/denohet-me-25-vite-burg-hashim-thaci/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 09:50:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 09:33:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6a28c9f06a7fccbceac369bb97d99feb80ef14901cf06873458cb88b2202e83
TEKSTI	c18b13032480f3b486848f3d53d7a37aa96658600a50250a91c9c28ed72d5a86
PAMJA	18101c993abd2ad567dc5320be5a2355aea3dbd7265f10f75ca6c0d4f334696b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	13929556a88927d3d9380dd6cfac6759eb543c15326e8d4e959e56975b5cc383
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	1f56947d1ce9865195ccff7ffa5c5fdb522467bffa0934ba4720654b865868030
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/13929556a88927d3d9380dd6cfac6759eb543c15326e8d4e959e56975b5cc383>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

[Home](#) [Aktualitet](#)

Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi

by **editor** — September 16, 2026 in Aktualitet, Kosovë, Kryesore0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Gjykata Speciale konstatoi se të 4 ish-drejtuesit e UÇK janë penalisht përgjegjës për vrasje të paligjshme. Hashim Thaçi është dënuar me 25 vjet burg.

Kush është Hashim Thaçi

Jeta e Hashim Thaçit paraqet një larmi ngjarjesh që janë të destinuara të bashkëjetojnë me historinë e Kosovës

.Thaçi, një student nga Skënderaj që u përfshi në protestat dhe organizimet e para kundër regjimit serb, arriti të spikasë në organikën e brishtë të UÇK gjatë luftës.

Ai u mbështet nga partnerët perëndimor si një lider politik i së ardhmes së Kosovës së lirë. Thaçi ndërtoi edhe një karrierë të pasur politike duke arritur në ushtrimin e detyrave të Kryeministrit dhe Presidentit të Kosovës. Hashim Thaçi lindi më 24 prill 1968 në Burojë të Skënderajt, në Drenicë.

Rajoni ku u rrit kishte një histori të gjatë të mobilizimit politik shqiptar dhe do të bëhej një prej zonave kryesore të konfliktit të armatosur në Kosovë në fund të viteve 90.

Pas shkolimit fillestar, Thaçi u orientua drejt studimeve në Universitetin e Prishtinës, ku u përfshi në Lëvizjen Studentore të Kosovës duke u bërë një prej drejtuesve të saj

Por shumë shpejt aktiviteti i tij do të kalonte përtej protestave studentore.

LPK dhe jeta jashtë Kosovës

Ai angazhohet në Lëvizjen Popullore të Kosovës, LPK, një organizatë politike që synonte ndryshimin e pozitës së shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

Shfaqja e UÇK-së

Në mesin e viteve '90, Kosova hyri në një fazë të re. Sulmet e armatosura të UÇK-së ndaj forcave dhe institucioneve serbe u shtuan. Në vitin 1998, konflikti u përshkallëzua në luftë të gjerë dhe Hashim Thaçi spikati si një prej figurave politike kryesore të UÇK-së.

Në atë kohë, ai njihej edhe me nofkën "Gjarpri".

Rambuqe, Thaçi del në skenën ndërkombëtare

Në shkurt të vitit 1999, emri Hashim Thaçi u bë i njohur përtej Kosovës.

Vetëm 30 vjeç, ai drejtoi delegacionin kosovar në bisedimet e Rambusës në Francë.

TË FUNDIT

Jakup Krasniqi dënohet me 25 vjet burgim nga Gjykata Speciale

SEPTEMBER 16, 2026

Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi

SEPTEMBER 16, 2026

Trupi gjykues: Krasniqi kishte dijeni për krimet, por nuk ndërmori hapa

SEPTEMBER 16, 2026

Trupi gjykues: Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e krimeve. Selimi, rol në arrestimin e 13 deputetëve

SEPTEMBER 16, 2026

Hidhet shorti për çështjen Veliaj-Dado

SEPTEMBER 16, 2026

Bie akuza për krime kundër njerëzimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

SEPTEMBER 16, 2026

Pritet vendimi i Gjykatës Speciale për Hashim Thaçin, kushëriri i ish-presidentit: Nëse dënohet, nuk do t'i tregojmë nënës së tij

SEPTEMBER 16, 2026

Specialja: Nuk pati krime kundër njerëzimit nga udhëheqësit e UÇK-së

SEPTEMBER 16, 2026

Gjykata Kushtetuese kalon për shqyrtim "Paketën e Maleve", kërkohet edhe pezullimi i ligjit

SEPTEMBER 16, 2026

OCCRP: "Revolucioni i Flamingos" përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për Edi Ramën

SEPTEMBER 16, 2026

Diplomati austriak Wolfgang Petritsch, një prej figurave të rëndësishme të procesit të Rambujesë, e konsideronte Thaçin një negociator shumë të ri dhe relativisht të papërvojë, por vlerësonte se ai mësoi shpejt gjatë negociatave.

Bisedimet nuk prodhuan një marrëveshje përfundimtare të pranueshme për të gjitha palët. Me palën shqiptare që pranoi të firmoste, ndryshe nga serbët, më 24 mars 1999, NATO nisi bombardimet ndaj Jugosllavisë.

Nga lufta në politikë

Pas përfundimit të luftës në qershor 1999, Thaçi do të bëhej një nga figurat kryesore të politikës në Kosovë. Në po atë vit ai do të themelojë Partinë e Progresit Demokratik të Kosovës, që më vonë do transformohet në Partinë Demokratike të Kosovës, ku Thaçi u zgjodh kryetar dhe e mbajti këtë post deri në vitin 2016.

2000–2016 – Kryetar i PDK-së

Në vitet 2005–2007, Thaçi ishte pjesë e Ekipit të Unitetit në negociatat për statusin e Kosovës, të udhëhequra nga i dërguari special i Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari.

Partia e tij do të fitojë zgjedhjet e nëntorit të 2008 dhe Thaçi u bë kryeministër.

Më 17 shkurt 2008, në Kuvendin e Kosovës, ai shpalli Kosovën shtet të pavarur.

Nga një student që protestonte në Prishtinë në fillim të viteve '90, Thaçi tashmë qëndronte në krye të qeverisë së një shteti që sapo kishte shpallur pavarësinë.

Kryeministër dhe President

Ai do të qëndronte si kryeministër deri në vitin 2014, kohë në të cilën qeveria e drejtuar prej tij nënshkroi në 2013-in marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë–Serbi.

Në vitin 2016, Thaçi u zgjodh president i Kosovës. Ai ishte ende detyrën e kreut të Shtetit kur jeta dhe rrugëtimi i tij politik, morën një kthesë të fortë.

Në 5 nëntor të 2020, ai dha dorëheqjen pasi u konfirmua aktakuza ndaj tij nga Dhomat e Specializuara të Kosovës. Në të njëjtën ditë, u transferua në Hagë, ku nisi përballja e gjatë me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Previous Post

Trupi gjyqësor: Krasniqi kishte dijeni për krimet, por nuk ndërmoi hapa

Next Post

Jakup Krasniqi dënohet me 25 vjet burgim nga Gjykata Speciale



editor

report.al

REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencja dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT


E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

0 SHARES

01



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçar



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.